



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 65 datë 04.08.2022

**“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT NË KUOTËN 20% PËR
PROJEKTIN E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT PËR
KOMUNITETET E VARFRA DHE TË PAFAVORIZUARA”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe ligjit 9936 i mdryshuar “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në shkresën nr.144/30 datë 28.07.2022 dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në bashkinë Gjirokastrë më datë 01.08.2022 me nr.8412 prot , lidhur me projektin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”(projekti 2.1.e). Nga ana e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë është miratuar lista e përfituesve për projektin e strehimit për vitin 2022 mbi fitues 16 me vlerë totale **14,548,670.0Lekë** , nga të cilat **shuma që bashkëfinancon Bashkia është 2,909,734.0Lekë** dhe **shuma që financon buxheti i shtetit është 11,638,936.0Lekë**, shuma për vitin **2023 është 4,017,740.0Lekë**.

Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës 04/08/2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë bashkëfinancimin në kuotën 20% të vlerës **2,909,734.0Lekë** për projektin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”.
2. Të miratojë listën fituese të aplikuar në kuadër të projektit të strehimit sipas listës bashkangjitur .
3. Të miratojë vlerën e mbikqyrjes dhe kolaudim në shumën 149,162.57Lekë.
4. Të miratojë përdorimin e burimeve të financimit si më poshtë :
Pakësohet Gr.00tit 04980 kap 01, art 609, kod programi 9999999 3,058,896.57lekë.
Shtohet Gr.00tit 06190 kap 01 , art 231, kod programi _____ 2,909,734Lekë.
Gr.00tit 06190 kap 01, art 231, kod programi _____ 149,162.57lekë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT
Lajdi HASANI

